



Të njohim Kuvendin e Shqipërisë

KUVENDI

Sipas Kushtetutës shqiptare, pushteti ligjvënës i është atribuar Kuvendit të Shqipërisë, i cili përbëhet prej 140 deputetësh. Deputetët zgjidhen çdo katër vjet nga të gjithë qytetarët që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Mandati 4-vjeçar zgjatet vetëm në rast lufte dhe për sa kohë që vazhdon ajo. Kuvendi është shprehje e sovranitetit të popullit. Në sistemin tonë kushtetues, Kuvendi bashkëpunon me Qeverinë në realizimin e drejtimit politik të shtetit. Atij i takojnë detyra të rëndësishme si kontrolli parlamentar dhe miratimi i ligjeve. Që të mund të qeverisë, Qeveria duhet të ketë besimin e Kuvendit. Deputetët votojnë për besimin e Qeverisë në fillim legjislature.

KRYETARI I KUVENDIT

Përgjegjësia për një organizim të pavarur dhe një funksionim sa më të mirë të Kuvendit i është besuar Kryetarit të Kuvendit, i cili përfaqëson këtë të fundit në kompleksitetin e tij. Kryetari kryeson Kuvendin si dhe disa organe parlamentare: Konferencën e Kryetarëve, Byronë Parlamentare, si dhe Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Rregullorja parlamentare parashikon zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit si aktin më të parë në fillim legjislature. Kryetari i Kuvendit, përveç kompetencave të parashikuara në Kushtetutë, ka edhe kompetenca të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit.

DEPUTETËT

Deputetët përfaqësojnë zgjedhësit. Sipas dispozitave kushtetuese çdo deputet, edhe pse i zgjedhur në një zonë të caktuar zgjedhore dhe nga një parti politike e caktuar, përfaqëson të gjithë popullin. Kuvendi përfaqëson orientime të ndryshme politike. Funksionimi i plotë i tij ka si premisë ekzistencën e grupeve parlamentare. Këto të fundit pasqyrojnë drejtimit e shprehura nga zgjedhësit sipas grupimeve të ndryshme.

ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

Në krye të administratës së Kuvendit qëndron Sekretari i Përgjithshëm, i cili sipas dispozitave kushtetuese është nëpunësi më i lartë civil i Kuvendit. Byroja e Kuvendit emëron, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, Sekretarin e Përgjithshëm mbi bazën e tre kandidaturave të dala nga procedura e konkurrimit, sipas ligjit "Statusi i nëpunësit civil". Administrata e Kuvendit, e përbërë prej rreth 295 punonjës, pjesa më e madhe e të cilëve e marrë me konkurs publik sipas ligjit të mësipërm, organizohet në shërbime, të cilat kryejnë detyra këshillimore, informuese, organizative dhe teknike në shërbim të veprimtarisë së deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij. Shërbimet e Kuvendit krijojnë mundësi dhe kushte të barabarta që deputetët, Kuvendi dhe organet e tij të kryejnë detyrat kushtetuese dhe ligjore.